



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-20-0580-A0001**

*Paditësi/Ankuesi*

V N, me përfaqësues sipas autorizimit av B I, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura*

**N.SH. N. “Sh”** (në likuidim), Mitrovicë, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë”

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-16-0262, të datës 8 dhjetor 2020, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 10 nëntor 2022, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-16-0262, të datës 8 dhjetor 2020.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 15 shkurt 2016, paditësja dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së me numër 6044/2014 të datës 13 tetor 2014, për shkak të kompensimit të pagave të papaguara për periudhën kohore 1991-2013 në shumën prej 135,516.67 € së bashku me kamatën ligjore. Paditësi si provë kishte bashkëngjitur një deklaratë lidhur me kërkesat e punëtorëve. Paditësja kishte pohuar se në këtë periudhë në vitet e 90-ta me vendimin e Kuvendit të Republikës së Serbisë ishin vendosur masat e dhunshme ku punëtorët shqiptarë ishin dëbuar nga puna, dhe nuk i është lejuar qasja fizike në objekt dhe nuk i është dhënë asnjë vendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me datë 20 mars 2016, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen ndaj parashtrësës së paditëses. AKP-ja në mbrojtjen e saj kundërshton padinë e paditëses si të pabazuar në ligj duke theksuar se nuk qëndron pohimi i paditëses së procedura e likuidimit kishte filluar në kundërshtim me nenin 7.4. të Ligjit për AKP, pasi që AKP ka filluar procedurat duke i përmbushur të gjitha kërkesat ligjore e përfshirë këtu edhe nenin 7.4. Nga shkresat e lëndës nuk mund të shihet se paditësi e kishte informuar ndërmarrjen dhe as AKP se ka ndonjë pretendim me çka rrjedhimisht pala e kishte humbur mundësinë ligjore që të kërkoj mbrojtje nga gjykata për realizimin e kësaj të drejte. AKP-ja kishte publikuar vendimin për futjen në likuidim të ndërmarrjes në fjalë në shtypin ditor me datë 17 qershor 2013 me anë të së cilit ishin njoftuar të gjithë kreditorët e mundshëm për parashtrimin e kërkesave të tyre. Sipas këtij njoftimi afati kishte filluar me 17 qershor 2013 ndërsa kishte përfunduar me 31 korrik 2013 përderisa paditësi me 3 shtator 2014 ka parashtruar kërkesën në zyrën regjionale në Mitrovicë. Prandaj, kishte propozuar që kërkesëpadia e paditësit të hudhet si e papranueshme. AKP-ja kishte bashkëngjitur si provë: Vendimin për futjen në Likuidim të N.SH. N. “Sh”-Mitrovicë, njoftimin për DHPGJS-në dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, njoftim për DHPGJS-në me nr. të protokollit 029/13 i datës 20 qershor 2013, një njoftim për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve për datën e fillimit të likuidimit të ndërmarrjes në fjalë me nr. 001/13 i datës 17 qershor 2013, Dëshmitë e publikimit në shtypin ditor, Vërtetime për pranimin e dërgesave, një Letër përcjellëse nga punëtorët e N.SH. N. “Sh” drejtuar Autoritetit të Likuidimit, Kërkesën për paga të papaguara dhe ndërprerje të parakohshme të punës për

punëtorët e N.SH. N. “Sh” dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. 6044/2014 të datës 13 tetor 2014.

Me datë 18 tetor 2016, paditësja kishte paraqitur përgjigje në mbrojtje të AKP-së në të cilën pretendonte AKP-ja ka zbatuar në tërësi nenin 7.4. të Ligjit 04/L-034 për AKP-në dhe thekson se nuk ka asnjë provë në shkresa të lëndës se paditësja e ka njoftuar Agjencinë me shkrim lidhur me pretendimet e veta, konstatim ky i gabuar pasi që paditësja bashkë me punëtorët tjerë me 27 gusht 2007, kishin paraqitur edhe kërkesën me shkrim pas shumë kërkesave me gojë, të cilën ia kanë dërguar AKM-së duke kërkuar që të mblidhet qeraja e objekteve në mënyrë që të jenë në gjendje të paguajnë pagat e tyre për shkak se ishin në gjendje shumë të rëndë sociale. Tutje, thekson se një detyrim tjetër i AKP ndaj punëtorëve që iu ishte ndërprerë marrëdhënia e punës ishte njoftimi i tyre lidhur me afatin e dorëzimit të kërkesave, mirëpo një gjë e tillë nuk kishte ndodhur, me të cilin mosveprim Agjencia nuk kishte përmbushur detyrimet e veta ligjore, prandaj kishte propozuar që kërkesa e paditëses të trajtohet si e dorëzuar me kohë dhe në merita të saj.

AKP me datë 2 tetor 2017 paraqiti kundërpërgjigje në përgjigje të paditëses e cila thekson se paditësja në përgjigjen e saj nuk ka paraqitur ndonjë provë, dëshmi apo fakt të ri për të cilin AKP-ja do të mund të deklarohet dhe të paraqes kundër argumentet e saj, prandaj deklarohet që mbetet në tërësi pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të parashtruara në Dhomën e Posaçme.

Me datë 8 dhjetor 2020, shkalla e parë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-16-0262, ankesën e paditëses e refuzoi si të pabazuar, ndërsa e vërtetoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër 6044/2014 të datës 13 tetor 2014. Në Aktgjykim arsyetohet se ndërmarrja kishte hyrë në proces të likuidimit me 11 qershor 2013, ndërsa AKP-ja kishte njoftuar DHPGJS për fillimin e likuidimit, ku njëherazi kishte njoftuar edhe të gjithë kreditorët potencial të N.SH. N. “Sh” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri më datën 31 korrik 2013. Nga shkresat e lëndës shihet se paditësja kërkesën e saj në AKP e kishte parashtruar me datë 4 shtator 2014, nga çka mund të shihet se kërkesa ishte paraqitur pas kalimit të afatit të parashtrimit të kërkesës tek AL, përkatësisht më shumë se një vit pas kalimit të afatit të shpallur. Prandaj, kërkesa e dorëzuar pranë AL me një vonesë të tillë ishte refuzuar si e

pavlefshme e si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në DHPGJS kundër vendimit në fjalë është refuzuar si e pabazuar.

Me datë 13 dhjetor, paditësja (në tekstin e mëtejme ankuesja), përmes përfaqësuesit të saj sipas autorizimit, av B I brenda afatit ligjor ka dorëzuar një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së (më tutje aktgjykimi i ankimuar), me nr. C-IV-16-0262 të datës 8 dhjetor 2020, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e ankueses, ndërsa të priset aktgjykimi ose lënda të kthehet në rigjykim duke detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të borxhit për paga të papaguara t'i paguaj paditësit shumën prej 135,516.67 € së bashku me kumatën ligjore si dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës të Odës së Avokatëve të Kosovës. Në ankesën e ankueses theksohet se ky likuidim është inicuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht me nenin 7.4 të Ligjit për AKP-në 04/L-034. Në rastin konkret Agjencia ka qenë e njoftuar që NSH-ja i ka gjithsejt njëzet e shtatë punëtorë të regjistruar dhe se të njëjtit në tërësi pa përjashtim kanë humbur marrëdhënien e punës për shkak të privatizimit atëherë ka qenë poashtu në njohuri se këtyre punëtorëve u takon dëmshpërblimi për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës si pasojë e veprimeve të AKP-së dhe rrjedhimisht është dashur t'i dërgoj me postë të rekomanduar njoftimin për likuidim çdo punëtori veç e veç duke i njoftuar se kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre në likuidim. Tutje, thekson se më 11 qershor 2013, AKP-ja nxjerri një vendim me të cilin filloi Likuidimin e ndërmarrjes shoqërore N.SH. N. "Sh" dhe asnjë nga punëtorët nuk ishte njoftuar për fillimin e këtij Likuidimi dhe nëse e konsiderojnë veten kreditor mund të paraqesin kërkesat e tyre në AKP. E paditura ishte e obliguar që për çdo kontratë apo marrëdhënie të përhershme të punës e cila ishte ndërprerë si rezultat i privatizimit të njoftonte zyrtarisht punëtorin për ndërprerjen e kësaj marrëdhënie. Pra, nëse AKP do të kishte ndërmarrë veprimet ashtu siç është e obliguar me ligj, ankuesi nuk do të ishte në situatën në të cilën gjendet tani, prandaj ankuesi kërkon nga Kolegji i Apelit që ankuesja të mos penalizohet për arsyen e vetme që është mosinformimi i saj nga ana e AKP-së. Ankesës si provë i kishte bashkëngjitur: Kërkesën Kreditore për paga të papaguara të datës 27 gusht 2007, përgjigjen në shkresë me nr.254 të datës 28 maj 2013, përgjigjen në shkresë me nr.271 të datës 4 qershor 2013, Njoftimin për MIT040 N.SH. "Sh"-Mitrovicë.

AKP-ja me datë 22 prill 2021 ka paraqitur përgjigje në ankesën e palës kundërshtare në të cilën thekson se argumentet e ngritura në ankesë janë të përsëritura dhe propozon që të refuzohet apeli si i pabazuar ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Autoriteti i Likuidimit në bazë të njoftimit të shpallur kishte informuar kreditorët që kërkesat e tyre ndaj N.SH-së nën likuidim t'i paraqesin nga data **17 qershor 2013** deri me datën **31 korrik 2013**. Ankuesja ka parashtruar kërkesën e saj pranë Autoritetit të Likuidimit me datë **4 shtator 2014**, rrjedhimisht pas afatit të përcaktuar me njoftimin e Autoritetit të Likuidimit. Ky njoftim, ashtu siç shihet nga provat në shkresa të lëndës ishte publikuar edhe në shtypin ditor Kosova Sot me datë **17 qershor 2013**.

Në këto rrethana të këtij rasti Autoriteti i Likuidimit me datë **13 tetor 2014** ka lëshuar një letër me të cilën njoftohet paditësja se kërkesa e saj e parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit është paraqitur pas afatit kohor, andaj ajo nuk do të shqyrtohet bazuar në Ligjin e AKP-së nr. 04/L-034.

Kolegji i Apelit konstaton se shkalla e parë e DHPGJS-së saktë ka vërtetuar se paditësja kishte paraqitur kërkesë të paafatshme tek Autoriteti i Likuidimit, për kompensimin e pagave të pretenduara ndaj N.SH-së në likuidim, prandaj padia me të drejtë është refuzuar si e pa bazuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se AKP-ja mjaftueshëm i ka përmbushur obligimet e saj ligjore për njoftimin e kreditorëve të mundshëm për paraqitjen e kërkesave ndaj NSH-së në likuidim duke e publikuar Njoftimin, andaj nuk mund të pranohet pretendimi i përfaqësuesit të paditëses i

paraqitur në ankesë se AKP-ja ishte e detyruar që për çdo kontratë apo marrëdhënie të përhershme të punës e cila është ndërprerë si rezultat i privatizimit të njoftonte zyrtarisht punëtorin duke lëshuar një dokument zyrtar-Letër Pezullimin.

Kolegji i Apelit vlerëson se shkalla e parë është dashur të vendos me Aktvendim dhe jo me Aktgjykim sepse kërkesa para Al. ishte e pa aftshme sikundër që gabimisht ka cituar vendimin e Autoritetit të Likuidimit sepse ai nuk ishte vendim por vetëm një Njoftim.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konsideron që Njoftimi i shpallur për mundësinë e dorëzimit të kërkesave në procedurën e likuidimit i ka përfshirë të gjithë kreditorët e mundshëm pa bërë dallim në kreditorët e njohur apo të pa njohur të NSH-së. Prandaj, përgjegjësia për dështimin e paraqitjes me kohë të kërkesës për paga, tek Autoriteti i Likuidimit nuk ka mundësi t'i bartet AKP-së siç pretendon paditësja, por ajo përgjegjësi duhet të bartet nga vetë paditësja dhe e njëjta duhet t'i pranoj pasojat ligjore të këtij dështimi.

Sipas nenit 11 të Ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t'i paguaj shpenzimet procedurale, përfshirë taksat gjyqësore të palës tjetër. Ankuesja në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë në barrë të saj.

Nga këto arsye duhet të refuzohet ankesa e ankueses si e pabazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Për arsyet e mësipërme e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendosë si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 7 janar 2021, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së me datë 10 nëntor 2022.

Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_

